

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale hidraulike”

Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara për një periudhë 12 mujore.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Materiale hidraulike 44115210-4

Fondi limit : 199,950,333,33 (njqind e nentedhjete e nente milion e nenteqind e pesedhjete mije e treqind e tridhjete e tre presje tridhjete e tre) **Lekë pa TVSH.**

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 2.087.164,23 (Dy milion e tetedhjete e shtate mije e njqind e gjashtedhjete e kater presje njezet e tre) **Euro.**

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise date 10.04.2026 është 95.80 euro.

Argumentimi: Perllogaritja e vleres se fondit limit eshte bere referuar Nenit 35 te ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 te VKM 285 date 19.05.2021, të ndyshuar

Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:

Kryerja e furnizimit të kërkuar nga AK nga operatorë të ndryshem ekonomikë nuk do të ishte i favorshem, pasi do të shoqërohej me kosto shtesë dhe vonesa të kryerjes së furnizimit, për kryerjen e procedurave të minikonkurimit nga AK, palë e kësaj MK.

Ndryshimi i OE në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE ku të gjitha kushtet nuk janë të përcaktuara do të shkaktonte kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për OE të suksesshëm, gjë që do të shoqërohej me rritjen e afateve të kryerjes së furnizimit.

Lidhja e MK me një OE të vetëm, do të shoqërohej me mirëorganizimin e këtij të fundit për kryerjen e furnizimit në kohë, sigurimin e bazës materiale në kohën e kerkuar nga AK.

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Bazuar në nenin 39 të LPP-së dhe në nenin 42 të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor vendos te mos e ndaje proceduren e prokurimit ne lote per arsye sepse kjo garanton dhe siguron efektivitet në lidhje me shpejtësinë e furnizimit me mallra.

Procedura me objekt **“Blerje Materiale Hidraulike”**, është e pamundur teknikisht të ndahet në lote sepse nga vete natyra e prokurimit kemi të bëjmë me një furnizim mallrash të cilat klasifikohen në të njëjtën familje të mallrave objekt prokurimi.

Autoriteti Kontraktor gjykon se ndarja në lote e kontratës së mësipërme nuk është praktike, pasi furnizimi i kërkuar nuk mund të copëzohet për shkak se tubat nuk mund të instalohen apo montohen në rrjetin e Ujësjellësit pa pasur njëkohësisht rakorderi sic mund të jenë reduktorët, manikodat, fllanxhat, saracineskat etj. Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e minikontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësive duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës.

Theksojmë se kjo procedurë është një procedurë e cila realizohet në mënyrë të përvitshme nga SHRUKD sh.a dhe për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtën natyrë mallrash ndër vite është është realizuar e përqendruar në një kontratë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor SHRUKD sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Lloji i procedurës është përzgjedhur në zbatim të nenit 42 te ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” I ndryshuar, “Vendimit te Keshillit te Ministrave 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar nenet 47; 59; 60 pika 1 germa ç; 61; 62; 63 pika 1; 64 pika 1 germa a; 65, VKM nr. 291, datë 15.5.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik.

1. I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 43, VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore të të ardhurave.

Percaktimi i vleres se kerkuar argumentohet si me poshte;

Pika 1 dhe pika 2/b, neni 43 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohej, përkatësisht; Pika 2/b: *vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar*;.. Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me parë, rëndësisë së objektit të prokurimit, rëndësisë së Autoritetit Kontraktor, seriozitetit të marrëdhënieve kontraktuale me operatorë ekonomikë me aktivitet të vazhdueshëm në treg gjykon se është e përshtatshme vendosja e këtij marzhi të përcaktuar në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023,2024 dhe 2025 të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 9, të Ligjit Nr.25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar;

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2025 sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, AK gjykon se kriteri i vendosur lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kërkesave pranë bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke opatur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet koititl aktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet te paraqesë Certifikaten e Cilësisë **ISO 9001-2015 ose ekuivalente** (e vlefshme), leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim, si dhe te jete ne perputhje me objektin e prokurimit. Certifikata duhet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, operatori ekonomik duhet te dorezoje certifikaten ISO sipas zerave që do te marre persiper sipas akt-marreveshjes.)

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020“Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.4.2 Operatori Ekonomik per te kryer procesin e Furnizimit prane AK, duhet te disponoje minimumi nje mjet transporti ne pronesi ose me qera me peshe te lejuar jo me pak se 3500 kg. Per te vertetuar keto OE duhet te paraqese vertetim per pronesine ose Kontrate Qeraje, shoqeruar me Lejen e Qarkullimit dhe Lejen e Transportit , te leshuar nga Organet perkatese

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten, ne kopje origjinale ose te noterizuara, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin nr.41 te LPP Pika 4/ç Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Sqarim; Referuar listes se materialeve hidraulike te kerkuara si: Tuba te dimensioneve te ndryshme, Saracineska, fllanxa, te cilat kane peshe specifike te larte dhe sasi te medha ku per transportin e tyre nevojitet mjet transporti. Per kete arsye grupi i hartimit te specifikimeve teknike kerkon qe mjeti te kete kapacitet mbajtes jo me pak se 3500 kg pasi do ishte e pamundur transporti i materialeve me peshe te larte .

2.4.3 Operatori ekonomik duhet te paraqese:

Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, OE duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

AK gjykon se kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi. Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

2.4.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/et e prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi.

Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, gërma b) të

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar parashikohet shprehimisht.... Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

2.4.5 Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti

Kontraktor në formën e një table, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës. Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr	Emertimi i produkteve	Emertimi kompanise prodhuese, adresa , web-siti	Emertimi i katalogut	Referenca ne katalogje/	Shënimet
				KOD I produktit ose nr. Faqes ne katalog	

Emërtimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK.

Emri, Adresa dhe website i kompanise prodhuese, me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në ofertim, Emertimi i Katalogut të prodhuesit., Referenca në katalogje, kodi i produktit (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr i faqes), duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut në katalogun perkates ku autoritetit kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Qëllimi i vendosjes të kriterit të sipërcituar ka të bëjë me faktin e orientimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në fazën e ofertimit të dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatorët pjesëmarrës.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë, markë, emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

2.4.6 Ofertuesi ne ditën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostrat pranë Autoritetit Kontraktor. Produktet të cilat kërkojnë të paraqiten mostrat janë të renditura si mëposhtë sipas numrit rendor në preventiv:

1,10,16,26,45,51,71,105,117,136,145,151,158,167,172,181,206,210,228,258,285,311,321,343,356,364,368,377,402,407,452,462,487,490,511,526,540,552,559,583,592,597,602,624,647,651,656,679,684,688,771,772,778,779,792,796,801,817,828,855,857,871,875,901,943,953,957,960,971,977,1000,1002,1006,1014,1016,1031.

Shënim: Kërkohej që OE në hapjen e ofertës të paraqesë një produkt mostër duke u bazuar në rëndësinë që kanë këto produkte. Në tregun Shqipëtar dhe atë Botëror ekzistojnë disa tipe të ndryshme cilësish, fakt ky që na detyron për të verifikuar paraprakisht produktet më të rëndësishme dhe për të qënë të sigurtë që ato do të jenë në cilësinë e duhur sipas specifikave të kërkuara, që mirëmbajtja e rrjetit të SHRUKD-së të jetë në nivelin më të mirë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.4.7.Për të gjitha mallrat të cilat kanë kontakt me ujë të pijshëm (sipas specifikimeve teknike) operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë të aprovimit për përdorimin e ujit të pijshëm DVGW, ose ekuivalente (të vlefshme) të lëshuar nga një trup i certifikuar ndërkombëtar apo kombëtar i akredituar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Referuar faktit se në preventivin objekt prokurimi kërkojnë mallra të cilat do kenë kontakt me të drejtpërdrejtë me ujë të pijshëm(furnizim jetik për qytetarin) kërkohej që cilësia të jetë e lartë e standarteve të kërkuara me qëllim mosndikimin e faktorëve të jashtëm në cilësinë e ujit.

2.4.8. Operatori ekonomik duhet të ketë në listepagese jo më pak se 3 punonjës. Për ta vertetuar këtë të paraqitet listepagesat e tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten, në kopje origjinale ose të noterizuara, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.

Shënim: Punonjësit do të kryejnë transportin e mallrave, ngarkimin dhe shkarkimin e tyre deri në ambientet e magazinave perkatese të Autoritetit Kontraktor, si dhe shpjegimet mbi përdorimin e mallrave nëse do të jete rasti.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Artikujt sipas numrit rendor 1-40 Tub HDPE100

Tuba polietileni me dendësi të lartë. Tubat të kenë një koeficient sigurie minimalisht 1.2 dhe të durojnë presione të larta pune. Materialet e përdorura për prodhimin e tubave të jene jo toksike dhe të mos ndikojnë në cilësinë e ujit (mos ti japin atij as erë as shije). Të jenë fleksibël dhe me rezistencë ndaj vibrimeve, për tu përshatur me relievin e tokës. Të jenë rezistent ndaj rrezeve ultraviolet dhe ndaj temperaturave -25 deri në 55°C. Të kenë rezistencë të lartë ndaj gërryerjes. Pamja e jashtme: të kenë sipërfaqe të lëmuar dhe pa dëmtime, të jenë ngjyrë e zezë me vija blu, prerja fundore e tubit duhet të jetë e pastër dhe në kënd të drejtë me qëndrën e tubit. Tubat duhet të jene të pershtatshem për bashkime me rakorderi kompresioni, saldime koke me koke dhe me elektrofuzion sipas normes DVS 2207-1 ose ekuivalente. Fortesia në terheqje duhet të jete jo më pak se 22 MPA. Densiteti jo më pak se 0.90 g/cm³. Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi të leshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm (p.sh DVGW). Tubat HDPE duhet të vertetojnë rezistencën e tyre ndaj presioneve të larta dhe deformimit mekanik ndaj forcave statike e dinamike duhet të jene konform me standardin EN 12201 ose ekuivalent, për të vertetuar këtë ofertuesi duhet të paraqesi në ofertën e tij certifikatën përkatëse.

Artikujt sipas numrit 41-49 Tub PP-R PN 16

Tubat PPR duhet të jene të perbera prej materiali cilesor polipropileni si dhe me perberje polimeri (kopolimer). Duhet të jene aftesi të mira të ruatjes së formës së tyre ndaj faktoreve të cilët ndikojnë në ndryshimet sasiore dhe vetite të materialit si fleksibiliteti dhe fluiditeti.

Tubat duhet të jene të prodhuara sipas EN ISO 15874-3 dhe të afta për të përballuar presione deri në 16 bar ose 1.6 MPa.

Tubat PP-R duhet të jene të pershtatshem për tu përdorur në linjat e ujit të pijshëm dhe të jene të certifikuar me certifikate aprovimi të leshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në linjat e ujit të pijshëm (p.sh DVGW).

Permasat e tubave PP-R janë sipas preventivit

Artikujt sipas numrit 50-53 Tuba Multistrad

Tubat Multistrad duhet te jene te perbere me shtresa prej alumini të salduar, te rrethuar me shtresa PE-RT të lidhura me ngjitës. Detajet e brendshme te tubit ,te përbërë me shumë shtresa qe te kete rezistencë më të lartë të temperaturës dhe presionit. Maksimumi presionit te funksionimit deri 65 °C: 10 bar. Trashësia e aluminit jo me pak se 300 µm.

Tubat duhet te jene te prodhuar sipas standardit DIN 4726, EN 1264 dhe duhet te plotesojne te gjitha kerkesat teknike per instalimet hidraulike.

Artikujt sipas numrit 54-59 Tub PVC-PVC-U

Tubat PVC-U dhe PVC duhet te jene te perbera prej materiali cilesor polimer resine te pa plastifikuar.Konstruktivisht duhet te jete e perbere 3 shtresash si dhe ne daljet e tubit duhet te jene me gomina me ne menyre qe te shmanget rrjedhja e fluidit pas instalimit ne nyjet perkatese te shkarkimit/kanalizimeve. Tubat PVC duhet te kene durueshmeri ndaj temperaturave nga -10 °C deri ne 50 °C si dhe fortesi sipas kategorise perkatese SN 10 dhe SN 4.

Tubat duhet te jene te prodhuar sipas standardit EN 1401 dhe duhet te plotesojne te gjitha kerkesat teknike per tubat e nendheshem te dranzhimit dhe kanalizimeve per te vertetuar kete ofertuesi duhet te paraqese ne ofertin e tij certifikaten perkatese.

Permasat e tubave PVC -PVC -U jane sipas preventivit.

Artikujt sipas numrit 60-73 Tub CE pa tegel

Tubat me nr rendor 60-66 duhet të jenë të prodhuara pa tegel saldimit dhe sipas teknologjise se petëzimit dhe ngjeshjes në temperatura shume të larta. Materiali i tubave duhet të jetë në përputhje me nivelin e parë të specifikimeve të produktit, sipas liçensës dhe standardit për prodhimin e tubove të linjës me fund të sheshtë dhe atyre pa tegel saldimit. Sipas standartit ASTM,API 5L, ISO DIN-2448 ose ekuivalent .Tubat me nr rendor 67-73 duhet të jenë të përbëra prej materiali celiku cilesor me saldimit spiral pershtatshem per linjat e ujesjellit.Tubat duhet te kene aftesi te mira salduese si dhe duhet te jene te prodhuara sipas standardit ANSI B36,ASTM ,API ose ekuivalentin e saj. Permasat dhe spesoret duhet te jene sipas preventivit.

Artikujt sipas numrit 74-91 Brryla celiku

Brrylat duhet të jenë të përbëra prej materiali celiku cilesor te pershtatshem per linjat e ujesjellesit.Kendi tyre duhet te jete i graduar 45° dhe 90°.Te jene lehtesisht te montueshem me rakorderi te tjera me ane te saldimit.Duhet te jene te prodhuara sipas standardit ANSI B36,ASTM,ASME ose ekuivalentin e saj. Te jene kunder korrozionit dhe konstruktivisht te forte dhe te pershtatshem per saldimit.

Permasat e duhet te jene sipas preventivit

Artikujt sipas numrit 92-94 Brryla PVC

Brrylat te jene te prodhuar prej materialit **PVC-U (polivinil klorid i ngurtë)**, i cili te karakterizohet nga nje rezistencë e lartë ndaj korrozionit, kimikateve dhe konsumimit. Brrylat duhet te jene prodhuar në kënde standarde **87°–90°**. Presioni nominal i punës duhet te jete **PN16**, ndërsa temperatura e rekomanduar e funksionimit duhet te jete rreth **0°C deri në 60°C**. Lidhja me rakorderite e tjera te realizohet kryesisht me **mufë për ngjitje me solvent**, ose dhe me **unazë gome** ne sistemet e kanalizimeve. Ata duhet te jene prodhuar sipas standardeve evropiane si **EN 1452** për sistemet e ujit dhe **EN 1401** për kanalizimet PVC, duke garantuar cilësi dhe jetëgjatësi të lartë të instalimit.

Permasat e tubave brrylave jane sipas preventivit.

Artikujt sipas numrit 95-120 Tub Kanalizimi i Brinjezuar HDPE SN8 dhe SN4

Tubat e Brinjezuar perdoren per rrjetet e kanalizimeve per dranazhimin e ujerave te ndotura . Tubat duhet te jene te perbere prej materiali polipropileni ose polietileni te nje cilesise teper te larte si dhe teknikisht duhet te kene veti te mira mekanike si psh fluiditeti, fortesia e mureve te tubacionit. Te jene rezistente ndaj kimikateve dhe te jene rezistent ne temperature minimalisht -20 deri ne +55°C. Tubi gjithashtu duhet te shfaqë rezistence te larte ndaj deformimeve mekanike qe vijne si pasoje e forcave statike apo dinamike mbi muret e tubacionit , prandaj kerkohej qe tubat te jene konform me standardin EN 13476-3 ose ekuivalentin e saj.

Tubat duhet te kene keto parametra:

Materiali: HDPE

Dendësia: $\geq 0.945 \text{ kg/m}^3$

Moduli i elasticitetit : $\geq 800 \text{ MPa}$

Koeficienti i zgjerimit termik linear: $\leq 0.17 \text{ mm/m}^\circ\text{K}$

Koeficienti i përçjellshmërisë termike: $23^\circ\text{C} \quad 0.36-0.5 \text{ W/mk}$

Temperatura e aplikimit : -40°C deri $+ 60^\circ\text{C}$

Rezistenca elektrike sipërfaqësore : $\geq 10^{13} \Omega$

Forca e unazës: Sipas standartit S SH EN ISO 9969 / EN ISO 9969.

Ofertuesi ne oferten e tij duhet te paraqesi certifikaten perkatese ne lidhje me standardin EN 13476-3 ose ekuivalentin e saj e cila vërteton qe tubat janë vlerësuar dhe plotëson kërkesat kombëtare të përcaktuara.

Artikujt sipas numrit 121-124 Tub B/A

Tub prej betoni. Te jete cilesor dhe pa plasaritje ti rezistojte ngjeshjes dhe sforcimeve te krijuara nga ngarkesa e inerteve apo dherave.

Permasat sipas preventivit

Artikujt sipas numrit 125-127 Tuba GRP

Tubat GRP duhet te jene prodhuar nga plastike e perforcuar me fibra qelqi dhe rreshire polimeri. Perdorimi i tyre te jete per furnizimin me uje te pijshem, transferimin e ujrave te zeza, per impiante trajtimi, linja kanalizimesh etj. Fibrat e qelqit midis shtresave te brendshme dhe te jashtme duhet te krijojne rezistence per te siguruar fortesi te tubit dhe ngurtesesi.

Rezistenca ne terheqje rrethore e tubit duhet te jete jo me pak se 250 MPa . Rezistenca aksiale ne terheqje duhet te jete jo me pak 120 MPa . Deformimi maksimal i lejuar nuk duhet te jete me pak se 0.17% . Dendësia e tubit duhet te jete **$1.85-2.1 \text{ g/cm}^3$** . Permbajtja e fibres se qelqit duhet te jete **$65-75\%$** . Shpejtesia maksimale e rrjedhes se ujit nuk duhet te jete me pak se 3 m/s . Klasa e ngurtesise se tubit nuk duhet te jete me e vogel se 5000 N/m^2 .

Tubat duhet te jene rezistent ndaj korrozionit, gerryerjes, rezistente ndaj substancave kimike, abrazionit si edhe antisizmik. Duhet te jene lehtesisht te montueshem dhe te cmontueshem. Presioni maksimal 16 bar . Te jene prodhuar sipas standartit ASTM 3517, EN1797 ose ekuivalente .

Artikujt sipas numrit 128-147 Manikota EF

Manikota EF duhet të jenë të prodhuara për tu përdorur në linjat e furnizimit me ujë të pijshëm. Manikotat duhet të ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin. Tensioni i ngjitjes të jetë 40 V dhe konektorët duhet të jenë me diameter $2-4 \text{ mm}$. Manikotat duhet të jenë të pajisura me një tregues për ngjitjen, këto tregues duhet të jenë të vendosura afër me konektorët dhe të jenë të sigurta që të mos ketë rrjedhje të materialit ngjites. Te gjitha dimensionet e manikotave të jenë të përshtatshme për tu salduar nga një makineri saldimi. Lënda e parë që do të përdoret për prodhimin e manikotave EF duhet të jetë e një cilësie tepër të lartë. Produktet duhet të jene te markuara ne trup me marken CE dhe produkti duhet te jete konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e saj, per kte ofertuesi duhet te paraqese ne dokumentacionin e tij certifikaten perkatese. Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi të leshuar nga Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm (p.sh DVGW).

Permasat e produkteve duhet te jene sipas preventivit.

Artikujt sipas numrit 148-150 Manikota GRP

Manikotat duhet te jene prodhuara nga plastika e perforcuar me fibra qelqi. Ato duhet te realizojne bashkime te ndryshme midis tubave GRP kryesisht në rrjetet e ujës-jellësit, kanalizimeve, industrisë kimike etj. Lidhjet e ndryshme të bashkimeve duhet të sigurohen nga guarnicionet e bera nga materiali elastometer, të cilat duhet të sigurojnë një lidhje të forte dhe qëndrueshme për të parandaluar ngarkesën direkte në tub në rast të rreshqitjes së tokës, termeteve etj apo dhe në kushte normale. Manikotat duhet të jene rezistente ndaj gerryerjes, korrozionit. Presioni i punës është 16 bar . Te jene lehtesisht te montueshme.

Permasat e produktit duhet te jene sipas preventivit.

Artikujt sipas numrit 151-156 Manikota PPR me dalje mashkull

Manikotat PPR duhet te jene te perbera prej materiali cilesor polipropilene si dhe me perberje polimeri (kopolimer). Duhet te jene aftesi te mira te ruatjes se formes se tyre ndaj faktoreve te ndryshme atmosferik. Te perdoren per presione 16 bar ose 1.6 MPa.

Manikotat PP-R duhet te jene te pershtatshem per tu perdorur ne linjat e ujit te pijshem dhe te jene te certifikuar me certifikate aprovimi te leshuar nga Institucion Nderkombetar ose Kombetar per perdorimin ne linjat e ujit te pijshem (p.sh DVGW). Ato duhet te jene rezistent ndaj ujit te fresket, ujit te kripur, kimikateve dhe lengjeve shume gerryes.

Permasat e manikotave PP-R jane sipas preventivit

Artikujt sipas numrit 157-164 Ovale PPR

Ovale PPR duhet te jene te perbera prej materiali cilesor polipropilene si dhe me perberje polimeri (kopolimer). Duhet te jene aftesi te mira te ruatjes se formes se tyre ndaj faktoreve te ndryshme atmosferik. Te perdoren per presione 16bar ose 1.6 MPa. Ato duhet te jene me ngjitje dhe me fileto.

Ovalet PP-R duhet te jene te pershtatshem per tu perdorur ne linjat e ujit te pijshem dhe te jene te certifikuar me certifikate aprovimi te leshuar nga Institucion Nderkombetar ose Kombetar per perdorimin ne linjat e ujit te pijshem (p.sh DVGW). Ato duhet te jene rezistente ndaj ujit te fresket, ujit te kripur, kimikateve industriale dhe lengjeve shume gerryes.

Permasat e ovaleve PP-R jane sipas preventivit

Artikujt sipas numrit 165-173 TEE kompresioni

Materiali te jete prej polipropilene me cilesi te larte te jete rezistete ndaj temperaturave nga -20 grad C deri ne 45 grad C, te jete rezistence ndaj faktoreve te tjere te jashtem dhe te mos jene i perbere nga substance te cilat ndikojne ne shijen dhe aromen e ujit. Koka e filetit te jete konike per te shmangur rrjedhjet e mundshme nga diferenca e tubacioneve +5mm, -5mm. Material anti korroziv dhe perberja e materialit te jete kundra ngjitjes se algave dhe baktereve. Produktet duhet te jene certifikate aprovimi te leshuar nga Institucion Nderkombetar ose Kombetar per perdorimin ne sistemet e ujit te pijshem (p.sh DVGW).

Permasat e produkteve duhet te jene sipas preventivit.

Artikujt sipas numrit 174-201 TEE PE

Produkti duhet te jene i perbere prej polietilene te nje cilesie te larte pasi perdorimi i saj do te jene ne linjat e ujesjellesit. TEE PE duhet te jene te pershtatshem per tu salduar ne linjat e ujesjellesit me teknologjine me bashkim. Produktet duhet te jene te markuara ne trup me marken CE dhe produkti duhet te jene konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e saj, per kete ofertuesi duhet te paraqese ne oferten e tij certifikaten perkatese. Produktet duhet te jene certifikate aprovimi te leshuar nga Institucion Nderkombetar ose Kombetar per perdorimin ne sistemet e ujit te pijshem (p.sh DVGW).

Permasat duhet te jene sipas preventivit.

Artikujt sipas numrit 202-218 TEE EF

TEE EF duhet te jene te prodhuara per tu perdorur ne linjat e furnizimit me uje te pijshem. TEE duhet te ketë të shënuara në trup gjithë të dhënat për saldimin. Tensioni i ngjitjes të jetë 40V dhe konektoret duhet të jenë me diameter 2-4mm. TEE duhet të jenë të pajisura me një tregues për ngjitjen, këto tregues duhet të jenë të vendosura afër me konektorët dhe të jenë te sigurta qe te mos kete rrjedhje te materialit ngjites. Te gjitha dimensionet e tee te jene te pershtatshme per tu salduar nga nje makineri saldimi. Lënda e parë që do te perdoret për prodhimin e tee EF duhet të jetë e një cilësie tepër të lartë. Produktet duhet te jene te markuara ne trup me marken CE dhe produkti duhet te jene konform me standardin EN 12201-3:2001 ose ekuivalentin e saj, per kete ofertuesi duhet te paraqese ne dokumentacionin e tij certifikaten perkatese. Produktet duhet te jene certifikate aprovimi te leshuar nga Institucion Nderkombetar ose Kombetar per perdorimin ne sistemet e ujit te pijshem (p.sh DVGW).

Permasat e produkteve duhet te jene sipas preventivit.

Artikujt sipas numrit 219-222 TEE PPR me ngjitje

Tee PPR duhet të jete te perbera prej materiali cilesor polipropileni si dhe me perberje polimeri (kopolimer). Duhet te kene aftesi te mira te ruatjes se formes se tyre ndaj faktoreve te ndryshme atmosferik.Te perdoren per presione 16bar ose 1.6 MPa. Ato duhet te jene me ngjitje.

Tee PP-R duhet te jene te pershtatshem per tu perdorur ne linjat e ujit te pijshem dhe te jene te certifikua me certifikate aprovimi te leshuar nga Institucion Nderkombetar ose Kombetar per perdorimin ne linjat e ujit te pijshem (p.sh DVGW). Ato duhet te jene rezistente ndaj ujit te fresket,ujit te kripur,kimikateve industriale dhe lengjeve shume gerryes.

Permasat e Tee PP-R jane sipas preventivit.

Artikujt sipas numrit 223-248 Reduksion PE

